

STATUTI
I SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“BIOLIVE” SHPK

Sot, në datën 10 Janar 2023 (dymijë e njëzet e tre) në cilësinë e ortakut të vetëm dhe në pajtim të plotë të dispozitave të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” si dhe të Ligjit Nr.9723 datë 03.05.2007 për “Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, Arbër Satka, atësia Luan dhe amësia Klodiana, shtetas Shqiptar, lindur në Berat dhe banues në Tiranë, me adresë Rruga “Irfan Tomini P.83 Sh.2 Ap.22; Njësia Administrative Nr. 5, Tiranë, me mjet identifikimi kartë identiteti me Nr. Personal J90122033P, mbështetur në legjislacionin shqiptar në fuqi, themelon këtë shoqeri me përgjegjësi të kufizuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë dhe në bazë të dispozitave të mëposhtme.

KAPITULLI I
EMRI, FORMA LIGJORE E SHOQERISË, SELIA, OBJEKTI, KOHËZGJATJA

NENI 1
EMËRTIMI I SHOQERISË

- (i) Shoqeria themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar. Emërtimi i shoqërisë është: “ BIOLIVE ” SHPK (më poshtë e quajtur “Shoqeria”);
- (ii) Shoqeria fiton personalitet juridik me regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.
- (iii) Shoqeria zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara nga Akti i Themelimit dhe Statuti i Shoqërisë, i cili është i bashkëlidhur këtij akti të themelimit dhe formon një pjesë integrale me të.

NENI 2
SELIA E SHOQERISË



- (i) Selia e Shoqerisë ndodhet në adresën: "Nr.Pasurie 242/57,ZK 1381,VOL 14,FQ 34,Rr. Çermë e Sipërme, Divjakë, Lushnje, Shqipëri"
- (ii) Shoqeria mund të hapë filiale, degë apo zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, duke respektuar ligjet në fuqi dhe dispozitat e këtij Akti Themelimi dhe Statuti.

NENI 3 OBJEKTI I SHOQERISË

Shoqeria ka për objekt:

- a) Prodhim, ambalazhim dhe tregtim me shumicë dhe pakicë i vajit të ullirit;
- b) Standartizim, dekantim dhe ruajtje në kushte optimale e vajit të ullirit;
- c) Import-Eksport i vajit të ullirit;
- d) Shërbime konsulente në fushën e agronomisë dhe teknologjisë ushqimore;
- e) Import-Eksport i ambalazheve, materialeve dhe pajisjeve të ndryshme të cilat do të konsiderohen të nevojshme dhe të dobishme për realizimin e qëllimit të shoqerisë dhe që nuk bien ndesh me legjislacionin shqiptar në fuqi;
- f) Transport i mallrave dhe produkteve;
- g) Gjithashtu, shoqeria mund të kryej çdo veprim, operacion apo transaksion tjetër komercial, industrial e financiar, të dobishëm apo plotësues ndaj përmbushjes së objektit të shoqerisë, me kusht që aktivitetet e mësipërme të mos jenë në kundërshtim dhe të mos alterojnë objektin parësor të veprimtarisë së shoqerisë.

Kjo shoqëri mund të ndryshojë emërtimin e saj, vendqendrimin, objektin e aktivitetit, të shtojë ortakë, ose të rrisë apo të zvogëlojë kapitalin e saj sipas vendimit të ortakut të vetëm të kësaj shoqërie.

NENI 4 KOHEZGJATJA

Veprimtaria e Shoqerisë si një entitet juridik fillon me miratimin e krijimit të saj nga ana e organeve kompetente të shtetit dhe Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një afat kohor të papërcaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit të saj pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Vendimi për prishjen e Shoqerisë merret nga Asambleja e Ortakëve.



KAPITULLI II KAPITALI

NENI 5 KAPITALI THEMELTAR I SHOQERISË

- (i) Kapitali themeltar i Shoqerisë është 10.000 Lekë (dhjetëmijë). Kapitali themeltar i Shoqerisë është terësisht i nënshkruar dhe i derdhur në të holla përkatësisht nga ortakët i vetëm Z. Arbër Satka
- (ii) Kapitali i Shoqerisë mund të rritet në të ardhmen, nëpërmjet nënshkrimit dhe shlyerjes së kuotave të reja nga ortakët të rinj, vetëm me vendim unanim të Asamblesë së Ortakëve, ku do të miratohet si rrija e kapitalit ashtu edhe hyrja e ortakëve të rinj. Ky kapital mund të shtohet sipas dispozitave ligjore dhe sipas vendimeve të ortakëve.
- (iii) Kapitali mund të zvogëlohet, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme së Ortakëve, në këtë rast të ortakut të vetëm, në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

NENI 6

Ortakët i vetëm ka të drejtë të transferojë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë pjesërisht apo terësisht kontributet e tij përfshirë dhe fondet dhe kontributet e pjesëve të kapitalit themeltar.

KAPITULLI III ADMINISTRIMI I SHOQERISË

NENI 7 ADMINISTRATORI

- (i) Shoqëria administrohet nga Administratori i Vetëm Z. Arbër Satka;
- (ii) Administratori i vetëm do të qendrojë në detyrë deri në momentin e revokimit të mandatit të tij nga Asambleja e Ortakëve;
- (iii) Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë në të gjitha rrethanat;
- (iv) Administratori mund t'u delegojë personave të tretë të caktuar prej tij, një pjesë apo të gjitha kompetencat e tij;
- (v) Administratori mund të shkarkohet në çdo moment me vendim të Asamblesë



së Ortakëve, të miratuar nga një apo më shumë ortakë që përfaqësojnë shumicën e kapitalit themeltar të Shoqërisë;

- (vi) Administratori merr vendim për ndryshimet e këtij Statuti dhe Aktit të Themelimit të Shoqërisë
- (vii) Administratori merr vendim për themelimin e shoqërive të reja ose aleanca që lidhen me shitjen, blerjen, pjesëmarrjen dhe investimin në projekte ekzistuese dhe të reja;
- (viii) Mandati i Administratorit është 5 (pesë) vjet, i rinovueshëm dhe zgjatet deri në vendimin pasardhës të Asamblesë së Përgjithshme, që vendos për revokimin, rinovimin e mandatit të tij apo emërimin e administratorit(eve) të ri.

KAPITULLI IV

EKSPERTI KONTABËL, VITI FINANCIAR DHE SHPËRNDARJA E FITIMEVE

NENI 8

EKSPERTI(ËT) KONTABËL TË JASHTËM

Eksperti kontabël i Shoqërisë do të emërohet nga Asambleja e Ortakëve nëse emërimi i tij është i detyrueshëm në bazë të legjislacionit në fuqi. Pasqyrat financiare të Shoqërisë do të auditohen të paktën një herë në vit nga një apo më shumë, ekspert kontabël të jashtëm. Me marrjen në dorëzim të raportit përkatës të auditimit, Administratori i Shoqërisë do të marrë të gjitha masat përkatëse për ndreqjen e parregullësive të konstatuara nga raporti. Eksperti kontabël mund të shkarkohet nga detyra me vendim të Asamblesë së Ortakëve për mos kryerjen e detyrës, gabime dhe për mungesë profesionalizmi.

NENI 9

VITI FINANCIAR

- (i) Viti financiar fillon në datën 1 janar dhe përfundon në datën 31 dhjetor të çdo viti kalendarik.
- (ii) Në përfundim të vitit kalendarik Administratori harton pasqyrat financiare të Shoqërisë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

NENI 10

SHPËRNDARJA E FITIMEVE



Pas miratimit të pasqyrave financiare vjetore, Administratori vendos në lidhje me shpërndarjen ose jo të fitimit, nëse ka. Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara, në këtë rast ortakut të vetëm.

KAPITULLI V PRISHJA DHE LIKUIDIMI, DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

NENI 11 PRISHJA DHE LIKUIDIMI

Në çdo moment e për çdo arsye që mund të çojë në prishjen e Shoqërisë, mënyrat dhe procedurat për kryerjen e likuidimit dhe emërimin e një apo më shumë likuidatorëve do të vendosen nga Asambleja e Ortakëve në përputhje me legjislacionin në fuqi.

NENI 12

Për të gjitha çështjet që nuk parashikohen nga ky Akt Themelimi dhe Statut i Shoqërisë do të zbatohen dispozitatë përkatëse të legjislacionit shqiptar në lidhje me shoqëritë tregtare.

NENI 13

- (i) Ky Statut mund të ndryshohet apo shfuqizohet, ose një Statut i ri mund të miratohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve.
- (ii) Ky Statut i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "BIOLIVE" Sh.p.k përpilohet në tre (3) kopje në gjuhën shqipe, që nënshkruhen rregullisht nga ortakut i vetëm.

**Ortakut i Vetëm
Arbër Satka**

